Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 254/19
Datë/Datum 03.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 254/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Goran Milenković– Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik"AS Tech" SH.P.K.- Prishtinë, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit te prokurimit, lidhur me aktivitetine prokurimit me titull:"Furnizim dhe mirëmbajtje e BMS, mirëmbajtja dhe servisimi i klimave Lot -1", me numër të prokurimit: 254-19-1748-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror(ASHNA),më datën 20.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.**REUZOHET**,si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik"AS Tech" SH.P.K.- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimitme titull:"Furnizim dhe mirëmbajtje e BMS, mirëmbajtja dhe servisimi i klimave Lot -1", me numër të prokurimit: 254-19-1748-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror(ASHNA).

II.**VËRTETOHET**, njoftimi për anulim te aktiviteti te prokurimit me titull"Furnizim dhe mirëmbajtje e BMS, mirëmbajtja dhe servisimi i klimave Lot -1", me numër të prokurimit: 254-19-1748-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror(ASHNA).

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues"AS Tech" SH.P.K.- Prishtinë,refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë me dt:04.04.2019
Hapja e ofertave është bërë me dt:26.04.2019
Kërkesë për rishqyrtim dt: 16.05.2019
Autoriteti Kontraktues me datën 17.05.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "AS Tech" SH.P.K.- Prishtinë,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me27.05.2019me nr. 254/19,kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit te prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Furnizim dhe mirëmbajtje e BMS, mirëmbajtja dhe servisimi i klimave Lot -1", me numër të prokurimit: 254-19-1748-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror(ASHNA),duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin59,dhe 60të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe,
- Nenin 41.7,9,11 dhe 12 i RrUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 31.05.2019ka autorizuar ekspertin shqyrtuesprofesional tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtuesnë raportin e dt:10.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:Eksperti shqyrtues konstaton se AK-së, përmes Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar e ka njoftuar OE ankues "AS tech" SHPK, ku i thotë: Gabimet aritmetikore janë më shumë se dy përçin (2%) i vlerës totale të ofertës, duke i dhënë sqarimet se për Lot 1 - Furnizim dhe mirëmbajtje e klimave, komisioni ka gjetur vërejtje ku janë bërë gabime në llogaritjen e çmimeve për njësi edhe vlera totale e ofertës ka qenë 7,715. 00€, ndërsa pas llogaritjeve të secilit pozicion total del të jetë 8,645.00€, pra tejkalon vlerën prej 930.00€ të ofertës së paraqitur.
Gabimet në llogaritje janë bërë tek këto pozicione 12.000 BTU 4 Cope,18.000 BTU 1 Cope dhe 24000 BTU4

Cope, Ndërrimi i ventilit katerkahor,Ndërrimi i motorit të fenit,Ndërrimi i motorit të flegres (stop motorit), Ndërrimi imotorit të pjesës së jashtme dhe Mbushja me gaz.

Te specifikimet teknike/Lista e çmimeve në fund është Totali i çmimit ku është dhënë çmimi total në vlerë 7,715. 00€, pra në këtë çmim është përfshirë edhe çmimi për 12.000 BTU 4 Cope,18.000 BTU 1 Cope dhe 24000 BTU4 Cope.
Operatori ekonomik në ankesë deklaron: Ne si OE nuk kemi të drejte ndryshimin e paramanës, shtimin ndonjë kolone as diçka tjetër, mirëpo nuk jep sqarime në lidhje me arsyetimin e AK-së, nuk e jep ndonjë analizë se si i ka llogaritur çmimet për 12.000 BTU 4 Cope,18.000 BTU 1 Cope dhe 24000 BTU4 Cope, dhe çmimi ofruar a e tejkalon dy përçin (2%) të ofertës.

Operatori ekonomik ankues "AS tech" SHPK, në ankesë thirret tek Neni 41.7, 41.9, 41.11 dhe 41.12 i RrUOPP-së, mirëpo neni 41.8, pika (ii) i RrUOPP-së, e sqaron:
Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përçin (2%) i vlerës totale të ofertës.
ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është me shume se +/- 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42.

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigjet si dhe duke pasur parasysh që në këtë aktivit të prokurimit për Lot -1, kemi një ofertues, të ju jepet mundësia më shumë ofertuesve), i rekomandoj panelit shqyrtues që vendimi mbi anulimin e aktiviteti të prokurimit të mbetet në fuqi.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 14.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 11.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues senuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues,përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i

inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi iOE-së z. Sadikudeklaroj:Kryetarit te panelit i dorëzoj paramasën e DT si dëshmi ku ne si Kompani, një ekspert si ky këtu nuk e merr të analizon lëndën si duhet ku Autoriteti Kontraktues ka kërkuar çmime për njësi ku ne kemi ofertuar me çmime për njësi dhe e njëjta na ka eliminuar për gabime aritmetike të cilat ka mund ti shohë me lartë edhe ai ku çdo ndërhyrje ne paramasë është shkelje e ligjit, kurse ne i kemi vendosur çmimet vetëm për njësi siç është kërkuar në paramasë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi iAK-së z. Fazliudeklarojë:Pas gabimeve aritmetikore qe i ka pa komisioni vlerësues te çmimi për njësi vlera e ofertës së OE ankues ka qenë 7.715. euro tek paramasa kapaciteti i stokut është 4 copë dhe behet një here në vit, çmimin e ka ofruar për një copë, ku gjithsejte janë 9 Klima kontrata është për 3 vite, duke u bazuar të neni 41.8 pika (ii) udhëzuesit operativ.

Gjatë prezantimit në seance Eksperti shqyrtues z. Muhadri deklarojë: Qëndroje prapa ekspertizës.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë qe ankesa e jonë të aprovohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesii AK-së deklaroj: Kërkojmë qe të refuzohet ankesa e OE si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, gjet seancës për shqyrtim kryesor sqaron se AK përmes Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar e ka njoftuar OE ankues "AS tech" SHPK, ku i thotë: Gabimet aritmetikore janë më shumë se dy përçin (2%) i vlerës totale të ofertës, duke i dhënë sqarimet se për Lot 1 - Furnizim dhe mirëmbajtje e klimave, komisioni ka gjetur vërejtje ku janë bërë gabime në llogaritjen e çmimeve për njësi edhe vlera totale e ofertës ka qenë 7,715. 00€, ndërsa pas llogaritjeve të secilit pozicion total del të jetë 8,645.00€, pra tejkalon vlerën prej 930.00€ të ofertës së paraqitur.
Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues teknik sqaron se Gabimet në llogaritje janë bërë tek këto pozicione 12.000 BTU 4 Cope, 18.000 BTU 1 Cope dhe 24000 BTU 4 Cope, Ndërrimi i ventilit katerkahor, Ndërrimi i motorit të fenit, Ndërrimi i motorit të flegres (stop motorit), Ndërrimi i motorit të pjesës së jashtme dhe Mbushja me gaz.Te specifikimet teknike/Lista e çmimeve në fund është Totali i çmimit ku është

dhënë çmimi total në vlerë 7,715. 00€, pra në këtë çmim është përfshirë edhe çmimi për 12.000 BTU 4 Cope, 18.000 BTU 1 Cope dhe 24000 BTU 4 Cope.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues –teknik konstaton se operatori ekonomik në ankesë deklaron: Ne si OE nuk kemi të drejte ndryshimin e paramanës, shtimin ndonjë kolone as diçka tjetër, mirëpo ankuesi nuk jep sqarime në lidhje me arsyetimin e AK-së, nuk e jep ndonjë analizë se si i ka llogaritur çmimet për 12.000 BTU 4 Cope, 18.000 BTU 1 Cope dhe 24000 BTU 4 Cope, e që çmimi ofruar a e tejkalon dy përçin (2%) të ofertës.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues teknik sqaron se operatori ekonomik ankues "AS tech" SHPK, në ankesë thirret tek Neni 41.7, 41.9, 41.11 dhe 41.12 i RrUOPP-së. Mirëpo neni 41.8, pika (ii) i RrUOPP-së, e sqaron:

Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përçin (2%) i vlerës totale të ofertës.

ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është me shume se +/- 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 62 i LPP-së duke u anuluar aktiviteti i prokurimit në fjalë për faktin se AK nuk ka asnjë oferte te përgjegjshme për aktivitetin e prokurimit ne fjale. Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetem Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror(ASHNA),

1x1 OE"AS Tech" SH.P.K.- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.